

**VENDIM**

**Nr. 156, dt. 08.07.2016**

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.07.2016, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratohen projektet e hartuara nga DRKK Korçë:
  - Restaurimi i elementeve të çatisë së Kishës së Shën Thanasit, Voskopojë;
  - Vendosja e tabelës informuese dhe sinjalistikës në Shpellën e fshatit Tren;
  - Tendat në Pazarin e vjetër Korçë;
  - Tuma Kamenicë me vërejtjen: të eliminohet bordura mbajtëse e gurit e tabelës së informacionit, muri rrethues të jetë mur guri i thatë;
  - Restaurimi i çatisë së banesës së Pajtim Halimit.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**